



## **KONFERENCË KOMBËTARE**

***“Korrupsioni zgjedhor; Nevoja për një reformë elektorale të thelluar dhe gjithëpërfshirëse”***  
***Datë 26 Janar 2016***

### **Nevoja për adresim**

Procesi zgjedhor për shkak të natyrës së tij, i cili është ndër të tjera pasqyrimi i një totali matematikor të vullnetit popullor, ka qenë dhe është i atakueshëm në shumë forma.

Vullneti i brendshëm tërësor i votuesve, i cili përcakton interesat publikë dhe privatë të qytetarëve, për një periudhë në rastin më afatgjatë 4 vjeçare, përballet me fushatën zgjedhore, e cila ka për qëllim ta drejtojë këtë vullnet sipas subjekteve zgjedhore.

Hapësira ndërmjet zhvillimit (sipas subjekteve zgjedhore) brenda rregullave të garimit elektorale dhe vesimit apo manipulimit të vullnetit në forma të jashëligjshme ose jo etike, përcakton integritetin e një procesi zgjedhor. Kësisoj çdo proces zgjedhor e ka të natyrshëm të përballet me sfidën e një afirmimi sa më të gjerë të integritetit të vet.

Korrupsioni është një term që prej kohësh ka marrë një kuptim të shumëfishtë dhe si koncept është zgjeruar në fusha të ndryshme.

I perifrashuar, dhe kuptimi që përdoret në këtë dokument, është përfitimi (avantazhimi, epërsia, dobia, të mira) me pa të drejtë (në shkëlqje të kuadrit ligjor, të etikës, moralit, zakoneve të mira, ndërshmërisë), në shkëmbim të një përfitimi tjetër (avantazh, epërsi, dobi, e mirë).

Ky fenomen, aq më tepër në një shoqëri dinamike dhe tejet ndërvepruese, shfaq rrezikshmëri dhe mundësi shfaqje në hapësira publike apo private, politike ose financiare, tregtare ose administrative.

Ndryshe nga vetë koncepti i korrupsionit, korrupsioni elektorale si koncept është ende në formësim dhe nuk gjen shumë vend në terminologjinë e proceseve zgjedhore. Pavarësisht kësaj, si fenomen ka ekzistuar që në format e para të demokracisë dhe mbajtjes së proceseve zgjedhore.

Me konsolidimin dhe standartizimin e proceseve zgjedhore, edhe koncepti i korrupsionit elektorale është plotësuar akoma më shumë.

Ky koncept përfshin tre nivele të votimit; *shkëlqja e kuadrit ligjor për mbajtjen e procesit zgjedhor, manipulimi (vesimi) i vullnetit të zgjedhësve dhe manipulimi i procesit të administrimit të votave.*

Të tri këto nivele mund të jenë shfaqje të ndryshme të pavarura, të ndërvarura ose mund të jenë në një shfaqje të vetme.

Demokracia shqiptare, me zbehjen e bipartizmit dhe rritjen e protagonizmit politik; me rritjen e njohurive mbi proceset zgjedhore dhe manovrave përkatëse të përdorura; me rritjen e aktorit financiar në politikë dhe me një paqëndrueshmëri të institucioneve në zbatimin e ligjit, po përballet gjithmonë e më shumë me fenomenin e korrupsionit elektorale.



## **Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë**

**Contact:** Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;  
E-mail: [info@zgjedhje.al](mailto:info@zgjedhje.al); Website: [www.zgjedhje.al](http://www.zgjedhje.al);

Në vazhden e zgjedhjeve të shkuara, diskutimi publik ka rritur shqetësimin për përfshirjen e personave me precedentë penalë, ose akoma më keq me të shkuar kriminale, për ngritjen e strukturave të mirëorganizuara për blerjen e votës, për fushata zgjedhore tejet të kushtueshme, të cilat ngrenë dyshime për shkelje të pragut ligjor dhe për financime në konflikt interesi, e të tjera problematika.

Muaji Janar shënon fillimin e gjashtëmujorin të tretë në axhendën e reformës në drejtësi të ndërmarrë. Ky gjashtëmujor parashikohet të jetë i ngjeshur me nisma legislative dhe pritet të përmbillet pjesa dërrmuese e reformës.

Përpos këtyre, në gjysmën e parë të vitit 2016 pritet të bëhet pjesë e diskutimeve dhe nismave ligjore për reformën në drejtësi edhe reforma zgjedhore. Një reformë që është e gjithëpranuar që duhet të jetë e thellë, si nga aktorët politikë dhe prej aktorëve vendas e të huaj me interes në çështjet zgjedhore.

Si e tillë, reforma zgjedhore duhet të adresojë së pari tërë problematikat e vërejtura në traditën 25 vjeçare të proceseve elektorale. Një traditë problematikash që zë rrënjë pikërisht tek fenomeni i korrupsionit elektorale.

Për këtë shkak Shoqëria Civile vlerëson me vend organizimin e një aktiviteti për t'i dhënë rëndësinë e duhur këtij fenomeni si një ndër sfidat serioze me të cilat po përballet demokracia dhe shoqëria shqiptare, ku është ftuar edhe Presidenti i Republikës si *“Kryetar i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit”* në realizimin e një konference me temë *“Korrupsioni zgjedhor; Nevoja për një reformë elektorale të thelluar dhe gjithëpërfshirëse”*.

Një konferencë ku të ftuar dhe pjesëmarrës do jenë përfaqësues të forcave politike kryesore, të institucioneve, të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të prezencës të misioneve të huaja.

Konferenca parashikohet të mbahet në datën 26 Janar 2016 dhe me një axhendë të ndarë në dy pjesë.

Folësit në pjesën e parë pritet të jenë të nivelit politik, ku përfshihen përfaqësuesit më të lartë të partive kryesore dhe të misioneve më të rëndësishme të përfaqësive të huaja. Fjalimet e tyre do të jenë përshëndetëse dhe pritet të shprehin mbështetjen dhe përkushtimin në zbatim të reformave që pritet të mbahen.

Pjesa e dytë i kushtohet aktorëve të shoqërisë civile dhe institucioneve dhe do të përbëhet nga ligjërata në nivel teorik / teknik, për t'u ndjekur më pas me grupe pune që do diskutojnë piketat kryesore mbi çështjen e korrupsionit elektorale.

Këto diskutime do rezultojnë në një dokument përfundimtar në ndihmë të reformës zgjedhore.

Dokumenti në fjalë nuk do tentojë të listojë amendime konkrete të kuadrit ligjor, por do të përpiqet të jetë një rezumë e tërë problematikave të vërejtura deri më sot në traditën shqiptare elektorale, duke ia lënë Komisionit Ad-Hoc detyrën e shqyrtimit të të gjitha problematikave dhe adresimin konkret të tyre me amendimet përkatëse ligjore.

Nga ana tjetër vetë ky dokument do të përmbajë edhe aktorët pjesëmarrës në hartimin e dokumentit duke i kërkuar Komisionit Parlamentar që në seancat dëgjimore të thërrasë të gjithë këta aktorë, duke i dhënë kësaj reforme dimensionin gjithëpërfshirës.



# **Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë**

**Contact:** *Tel/fax:* + 355 4 2245078; *Mob.* + 355(0)692469393; (0)682039297;  
*E-mail:* [info@zgjedhje.al](mailto:info@zgjedhje.al); *Website:* [www.zgjedhje.al](http://www.zgjedhje.al);

## **KONFERENCË KOMBËTARE**

**“Korrupsioni zgjedhor;  
Nevoja për një reformë elektorale të thelluar dhe gjithëpërfshirëse”**

*Hotel Tirana International, datë 26 Janar 2016*

### **PROGRAMI PARAPRAK**

09.30-10.00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

#### **I. Paneli Politik. Pjesëmarrës në panel:**

Presidenti i Republikës së Shqipërisë *Sh.T.Z. Bujar NISHANI*

Kryetari i Partisë Socialiste (*njëherësh Kryeministri i Shqipërisë*) *Sh.T.Z. Edi RAMA*

Kryetari i Partisë Demokratike *Z. Lulzim BASHA*

Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim (*njëherësh Kryetar i Kuvendit*) *Sh.T.Z. Ilir META*

Ambasadorja e Bashkimit Europian *Sh.S.Znj. Romana VLLAHUTIN*

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës *Sh.T.Z. Donald LU*

Zv/Ambasadori i Delegacionit të OSBE-së *Z. Robert WILTON*

Përfaqësues i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV)

10:00 – 10:05 Fjala e hapjes  
*Përfaqësues i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë*

10:05 – 10:20 Fjala e Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
*Sh.T.Z. Bujar NISHANI*

10:20 – 10:35 Fjala e Kryetarit të Partisë Socialiste  
*Kryeministri i Shqipërisë Sh.T.Z. Edi RAMA*

10:35 – 10:50 Fjala e Kryetarit të Partisë Demokratike  
*Z. Lulzim BASHA*

10:50 – 11:05 Fjala e Kryetarit të Partisë Lëvizja Socialiste Për Integrim  
*Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Sh.T.Z. Ilir META*

11:05 – 11:15 Fjala Ambasadores së Bashkimit Europian  
*Sh.S.Znj. Romana VLAHUTIN (TBC)*

11:15 – 11:25 Fjala e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës  
*Sh.T.Z. Donal LU*

11:25 – 11:35 Fjala e Zv/Ambasadorit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri  
*Z. Robert WILTON*

11:35 – 11:50 *Pushim kafe (15 min)*



## **Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë**

**Contact:** Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;  
E-mail: [info@zgjedhje.al](mailto:info@zgjedhje.al); Website: [www.zgjedhje.al](http://www.zgjedhje.al);

### **II. Paneli teorik / teknik. Pjesëmarrës në panel:**

Avokati i Popullit Z. *Igli TOTOZANI*

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Znj. *Lefterije (LLESHI) LUZI*

Drejtoresha Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, znj. *Vjollca MEÇAJ (ish-anëtare e Gjykatës Kushtetuese)*

Koordinatori i Grupimit të Partive Jashtë Parlamentare Z. *Eduart ABAZI*

Shoqata e Bashkive Z. *Agron HAXHIMALI (ekspert)*

Përfaqësues i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV)

Ekspertë të huaj

11.50 – 12.00 Fjala hyrëse - *Përfaqësues i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë*

### **II.1. Procesi Zgjedhor, Korrupsioni dhe Korrupsioni Elektoral**

12:00 – 12:10 “Roli i Avokatit të Popullit në adresimin e problematikave që çenojnë liritë dhe të drejtat politike të qytetarëve; Fenomeni i Korrupsionit Zgjedhor”  
*Z. Igli TOTOZANI, Avokat i Popullit*

12:10 – 12:20 “Rritja e rolit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në kontrollin financiar të partive politike dhe modelet ku mund të mbështetet Shqipëria”  
*Znj. Lefterije (LLESHI) LUZI, Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve*

12:20 – 12:30 “Korrupsioni Elektoral dhe çënimi i vlefshmërisë së proceseve zgjedhore”  
*znj. Vjollca MEÇAJ, Drejtore Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit*

12:30 – 12:40 “Tjetërsimi i votës, që prej sistemit elektoral deri tek procesi i numërimit”  
*Z. Eduart ABAZI, Koordinator i Grupimit të Partive Jashtë Parlamentare*

12:40 – 12:50 “Pasqyrimi i Reformës Territoriale në reformën zgjedhore”  
*Z. Agron HAXHIMALI, Ekspert i Pushtetit Vendor*

12:50 – 13:00 “Elementë të Korrupsionit Zgjedhor në procesin e fundit zgjedhor”  
*Përfaqësues i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV)*

13:00 – 13:10 “Përvoja të huaja në luftën ndaj korrupsionit zgjedhor”  
*Ekspert i Këshillit të Europës (TBD)*

13:10 – 13:20 “Korrupsioni elektoral si pengesë e përfshirjes së femrave në politikë”  
*Z. David SAUNDERS (TBC)*  
*Përfaqësues i Programit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Forcimin e Rolit të Grave në Shqipëri (UN WOMEN)*



## **Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë**

**Contact:** Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;  
E-mail: [info@zgjedhje.al](mailto:info@zgjedhje.al); Website: [www.zgjedhje.al](http://www.zgjedhje.al);

### **II.2. Përcaktimi i problematikave që kanë nevojë për adresim konkret gjatë procesit të Reformës Elektorale, mbi bazën e konkluzioneve të nxjerra nga diskutimet në Grupet e Punës të krijuara sipas profileve të pjesëmarrësve në Konferencë.**

13:20 – 14:00 Ndarja e pjesëmarrësve në Grupe Pune (GP 1-10) sipas profileve profesionale apo përfaqësuese të tyre, si OJF, institucione, parti politike, media, etj., si dhe zhvillimi i diskutimeve brenda Grupit në temat:

- Shkelja e kuadrit ligjor në proceset zgjedhore (*vonesat e administratës në kryerjen e detyrave të ngarkuara; infrastruktura e paplotë e votimit; trajnimi i anëtarëve të komisioneve zgjedhore, etj.*)
- Manipulimi i vullnetit të votuesve në proceset zgjedhore (*drejtimi dhe blerja e votës; mungesa e transparencës në financat e partive politike; mbulimi mediatik i fushatës zgjedhore, etj.*)
- Shtrembërimi i procedurave të administrimit të votave (*procesi i numërimit të votave, etj.*)

- GP-1* Institucionet shtetërore që lidhen me zgjedhjet : *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Prefektura, Ministria e Pushtetit Vendor, etj.*
- GP-2* Partitë politike joparlamentare.
- GP-3* Financimi i partive politike dhe i fushatave zgjedhore: *Kontrolli i Lartë i Shtetit, Instituti i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, OSHC, etj.*
- GP-4* OSHC me eksperiencë në vëzhgimin e zgjedhjeve.
- GP-5* Personat me Aftësi të Kufizuar: *Avokati i Popullit, OSHC që punojnë me njerëzit me aftësi të kufizuar, etj.*
- GP-6* Pjesëmarrja Gjimore: *OSHC që punojnë më çështjet e pjesëmarrjes gjimore, etc.*
- GP-7* Media: *AMA, ish-anëtarë të Bordit të Monitorimit të Medias, OSHC të medias, etj.*
- GP-8* Qytetarë dhe ish-komisionerë.
- GP-9* Minoritetet: *Avokati i Popullit, OSHC dhe parti politike të fokusuar mbi minoritetet, etj.*
- GP-10* Pjesëmarrja e të rinjve: *OSHC që punojnë me çështjet e pjesëmarrjes së të rinjve, etj.*

### **II.3. Shkëmbimi dhe diskutimi i konkluzioneve**

14:00 – 14:30 Komunikimi i konkluzioneve dhe diskutime të lira nga pjesëmarrësit

14:30 Mbyllja e Konferencës. *Drekë Bufe.*